



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 17 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, nenit 17 të Rregullores QRK nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të neneve 15 paragrafi 2.4, dhe nenit 17 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 mars 2024, miratoi këtë;

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00596-0 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë, me sipërfaqe prej 16214 m² në vendin e quajtur "Fshati", me shfrytëzim aktual Tokë jo pjellore, me destinim sipas Hartës Zonale-Miniera dhe Gurore

Neni 1

Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës për 10 (dhjetë) vite, sipas vendimit nr.prot.01-020/04-0020869/24 të datës 29 mars 2024 për miratim paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik, pronën e paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00596-0 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej 16214 m² në vendin e quajtur "Fshati", me shfrytëzim aktual Tokë jo pjellore, me destinim sipas Hartës Zonale-Miniera dhe Gurore, në këtë përbërje:

1. **z.Bahri Selimi**, nga Ekzekutivi i Komunës
2. **znj.Xhevrie Beqiri**, nga Ekzekutivi i Komunës
3. **z.Illir Koprani**, nga Kuvendi i Komunës
4. **znj.Qëndresë Hajrizi**, nga Kuvendi i Komunës
5. **z.Rilind Konushevc**i, nga sektori joqeveritar lokal

Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni dhe i njëjti organizon dhe kryeson punën e komisionit.

Neni 2

Mandati i Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, përkatësisht për zbatimin e vendimit me nr.prot.01-020/04-0020869/24 të Kuvendit të Komunës për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës të datës 29 mars 2024.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe Rregulloren QRK 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Drejtoritë dhe shërbimet tjera përkatëse të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje këtij komisioni vlerësues për zbatimin e proceduarave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 6

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-020/04-0020863/24
Podujevë, datë, 29 mars 2024

